



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION

PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.2, DATË 31.1.2023, TË
KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MIRATIMIN E DISA KARAKTERISTIKAVE
TEKNIKE TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023”

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 20, pika 1, shkronja “g”, dhe 3 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për furnizimin dhe administrimin e materialit zgjedhor.

Neni 98, pika 1 ka parashikuar kompetencën e KQZ-së për përgatitjen e fletëve të votimit.

Në zbatim të dispozitave të sipërcituara, është hartuar projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr.2, datë 31.1.2023, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

II. PËRMBLEDHJE SHPIEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Me vendimin nr.2/2023 Komisioni Rregullator ka miratuar disa karakteristika teknike të fletëve të votimit që do të përdoren për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Neni 97, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore zgjedhësi voton me dy fleta votimi me formë të njëjtë dhe me ngjyra të ndryshme, një për kryetarin e njësisë së qeverisjes vendore dhe një për këshillin e bashkisë. Pika 3/1 e këtij neni përcakton që ngjyra e fletës në zgjedhjet e qeverisjes vendore, është e njëjtë në të dyja anët e saj.

Sikundër është argumentuar edhe në relacionin shpjegues të vendimit nr.2/2023, propozimi për kodet e ngjyrave u bazua në përvojën e deritanishme të ndjekur edhe në zgjedhjet e mëparshme, të viteve 2015 dhe 2019.

Administrata e KQZ-së menjëherë pas miratimit të vendimit u angazhua në lëvrimin e programeve të edukimit për zgjedhësit me simulimin e procesit të votimit me modelet e fletëve të votimit të printuara sipas kodeve të miratuara. Në këto sesione të edukimit të zgjedhësve që i përkasin grupeve të ndryshme, u përcoll konsiderata për të rivlerësuar ngjyrat e fletës së votimit. U konstatua që ngjyrat dalin me nuancë të fortë dhe nuk lejojnë plotësisht evidentimin e përmbajtjes së fletëve të votimit.

Emrat e kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore duhet të duken qartë dhe të krijojnë lehtësi për t'u lexuar nga ana e të gjithë zgjedhësve, varësisht moshës së tyre. Evidentimi qartë i emrave të kandidatëve dhe subjekteve zgjedhore që garojnë ka përparësi për procesin e votimit.

Në këto kushte, u konkludua që t'i propozohet Komisionit Rregullator, ndryshimi i kodeve të ngjyrave për të dyja fletët e votimit, si vijon:

Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie është Pantone 366 C (R 217, G 238, B 183) 60%, (një ngjyrë e gjelbër e fortë).

Propozohet të ndryshohet: PANTONE 7401 U (ngjyrë e artë).

Kodi i ngjyrës së fletës së votimit për kandidatët për anwtarwt e kwshillit bashkiak është Pantone 108 C (R 247, G 219, B 23) 60%, (një ngjyrë e verdhë e fortë).

Propozohet të ndryshohet: PANTONE 179 – 2 U (ngjyrë gri).

Bashkëlidhur këtij relacioni shpjegues gjenden të ilustruara ngjyrat siç janë miratuar dhe si propozohet të ndryshohen.

Një ndryshim tjetër që propozohet është heqja e përcaktimit të orientimit të fletëve të votimit. Vendimi ka miratuar që fleta e votimit për kandidatët për kryetar bashkie, të ketë orientimin "portret", ndërsa fleta e votimit për kandidatët për këshillat bashkiakë, të ketë orientimin "peizazh". Duke qenë se orientimi i fletëve të votimit duhet të përshtatet me numrin e kandidatëve dhe të subjekteve zgjedhore, sugjerojmë që ky përcaktim të lihet në diskrecion të vendimmarrjes për miratimin e fletëve të votimit, varësisht subjekteve zgjedhore që do të regjistrohen në zgjedhjet e 14 Majit 2023.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, projektvendimin "Për disa ndryshime në vendimin nr.2, datë 31.1.2023, të Komisionit Rregullator, "Për miratimin e disa

karakteristikave teknike të fletëve të votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Kopje: 3

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

P. Doçaj _____

M.Koja _____

A.Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI